



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-04

**Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës**

**Vendosi:** Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Veld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 11 korrik 2024

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendimi i Shtatë për Heqjen e Redaktimeve ose Zbatimin e Redaktimeve të Reja  
në Transkriptet e Seancave Gjyqësore dhe Riklasifikimin e tyre**

**Me Shtojcën 1 konfidenciale**

---

**T'i njoftohet:**

**Prokurores të Specializuar**

Kimberli P.Uest

**Mbrojtjes së të akuzuarit**

Zhan-Lui Zhilisen

**Zyrës Administrative**

Fidelma Donlon

**Mbrojtjes së Viktimave**

Sajmon Loz

**TRUPI GJYKUES I** (Trupi Gjykues) lëshon këtë vendim të shtatë për heqjen e redaktimeve ose zbatimin e redaktimeve të reja në transkriptet e seancave gjyqësore dhe riklasifikimin e tyre.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 15 maj 2023, Trupi Gjykues urdhëroi palët dhe mbrojtësin e viktimave të ndërmarrin në vijimësi rishikimin e transkripteve pas përfundimit të çdo blloku dëshmish dhe, në një parashtrim përmbledhës, të paraqesin parashtrime për mundësinë e heqjes të redaktimeve ekzistuese dhe/ose të riklasifikimit të transkripteve si publike, me qëllim respektimin e parimit të gjykimit publik, duke ruajtur masën mbrojtëse për dëshmitarët dhe viktimat.<sup>1</sup>
2. Më 12 qershor 2023, Trupi Gjykues udhëzoi Zyrën Administrative, sidomos Zyrën për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve (ZMMD), të lidhej me palët dhe mbrojtësin e viktimave dhe propozimet e tyre për heqjen e redaktimeve dhe/ose riklasifikimin e transkripteve t'ua shtonin, nëse dëshironin, parashtrimeve të përbashkëta të palëve dhe të mbrojtësit të viktimave.<sup>2</sup>
3. Më 5 qershor 2024, Trupi Gjykues mori Parashtrimet e Mbrojtjes lidhur me Propozimin e Përbashkët për Heqjen e Redaktimeve në Deklaratat Përmbyllëse me Shtojcën 1 Konfidenciale” (“Propozimet e Përbashkëta”) me propozimet e Mbrojtjes dhe komentet dhe/ose mospajtimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, mbrojtësit të viktimave dhe të Zyrës Administrative.<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup>KSC-BC-2020-04, F00510, Trupi Gjykues I, *Urdhri i Dytë për Parashtrime në lidhje me Heqjen e Redaktimeve dhe/ose Riklasifikimin e Transkripteve të Seancave Gjyqësore*, 15 maj 2023, publik, para. 5, 8.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-04, F00541, Trupi Gjykues I, *Vendim mbi Heqjen e Redaktimeve ose Zbatimin e Redaktimeve të Reja në Transkriptet e Seancave Gjyqësore dhe Riklasifikimin e Tyre*, 12 qershor 2023, publik, para. 25, me Shtojcën 1, konfidencial.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-04, F00840, Mbrojtja, *Parashtrime të Mbrojtjes në lidhje me Propozimin e Përbashkët për Heqjen e Redaktimeve dhe Deklaratat Përmbyllëse*, 5 qershor 2024, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

## II. PARASHTRIMET

4. Palët, mbrojtësi i viktimave dhe ZMMD-ja parashtrojnë propozimet e tyre për heqjen e redaktimeve dhe/ose riklasifikimin e transkripteve të deklaratave përmbyllëse, të cilat u mbajtën më 15, 16, dhe 17 prill 2024 (“Deklaratat Përmbyllëse”),<sup>4</sup> në varësi të zbatimit të redaktimeve në to, sipas nevojës, për të mbrojtur identitetin e dëshmitarëve dhe viktimave dhe informacionin e lidhur me ta.<sup>5</sup>

## III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Trupi Gjykses ka parasysh nenet 21(2), 23, 40(2), (4) dhe (6)(f) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe rregullat 80, 84(1) dhe 120 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).

## IV. ANALIZË

6. Trupi Gjykses kujton se, sipas nenit 21(2) të Ligjit, dhe në varësi të ndonjë mase mbrojtëse të urdhëruar sipas nenit 23 të Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave, i akuzuari ka të drejtë për një seancë publike në përcaktimin e akuzave kundër tij. Me qëllim respektimin e parimit të gjykimit publik, duke ruajtur masat mbrojtëse të marra, Trupi Gjykses ka ushtruar detyrën e tij sipas rregullës 84(1) të Rregullores për rishikimin e klasifikimit të transkripteve të Deklaratave Përmbyllëse dhe urdhëron riklasifikimin e tyre, sipas rastit, sikundër është përcaktuar më parë. Për lehtësi referimi, Trupi Gjykses rendit të gjitha

---

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-04: T. 15 prill 2024, publik, f. 4077-4169; T. 16 prill 2024, publik, f. 4170-4281; T. 17 prill 2024, publik, f. 4282-4374.

<sup>5</sup> Shtojca 1 e Propozimeve të Përbashkëta, f. 2-13.

riklasifikimet dhe redaktimet që duhen bërë nga Zyrën Administrative në transkriptet përkatëse në shtojcën bashkëngjitur këtij vendimi.

7. Trupi Gjykses vëren se palët, mbrojtësi i viktimave dhe ZMMD-ja pajtohen se disa pjesë të transkripteve të Deklaratave Përmbyllëse të mbajtura në seancë private mund të bëhen publike, disave pasi t'u bëhen redaktime.<sup>6</sup>

8. Në këtë drejtim, Trupi Gjykses konstaton se propozimet e bëra nga palët, mbrojtësi i viktimave dhe ZMMD-ja janë në përputhje me qasjen e Trupit Gjykses lidhur me mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave sipas nenit 23 të Ligjit dhe se ato vendosin një ekuilibër të duhur midis të drejtave dhe interesave të ndryshme në diskutim, konkretisht, midis parimit të gjykimit publik sipas nenit 40(4) të Ligjit, the të drejtës së të akuzuarit për seancë publike sipas nenit 21(2) të Ligjit, dhe mbrojtjes së dëshmitarëve dhe viktimave sipas nenit 23 të Ligjit.

9. Trupi Gjykses miraton pjesërisht kërkesat e Propozimeve të Përbashkëta për riklasifikimin si publike të pjesëve të transkripteve të Deklaratave Përmbyllëse, me kusht që të bëhen redaktimet e kërkuara dhe redaktime të tjera nga Trupi Gjykses, sikundër përcaktohet në shtojcën e këtij vendimi.

10. Nga ana tjetër, Trupi Gjykses vendos të mbajë klasifikimin konfidencial të pjesëve të mëposhtme, për shkak se riklasifikimi i tyre si publik ka gjasa se do të nxirrte hollësi identifikuese të dëshmitarëve dhe personave të tjerë të rrezikuar dhe se çdo redaktim i bërë nuk do ta kundërbalanconte këtë rrezik ose do ta bënte tekstin të pakuptueshëm, dhe rrjedhimisht të pakuptimtë:

- **Transkripti i 15 prillit 2024**
  - Faqja 4110, rreshti 22 deri te faqja 4112, rreshti 19.
- **Transkripti i 16 prillit 2024**
  - Faqja 4178, rreshtat 3-24;

---

<sup>6</sup> Shtojca 1 e Propozimeve të Përbashkëta, f. 2-13.

- Faqja 4261, rreshtat 2-14.
- **Transkripti i 17 prillit 2024**
  - Faqja 4305, rreshtat 17-21;
  - Faqja 4319, rreshtat 11-23;
  - Faqja 4372, rreshtat 18-23.

11. Mbështetur në sa më lart, Trupi Gjykses urdhëron Zyrën Administrative të riklasifikojë, si publike, pjesë të transkriptit të seancave private, në pajtim me udhëzimet e përfshira në shtojcën e këtij vendimi, dhe pasi t'i bëhen redaktimet që përmban. Riklasifikimi i lartpërmendur i transkripteve zbatohet njëllor në transkriptet në gjuhën shqipe dhe serbishte.

12. Së fundi, Trupi Gjykses përfshin përmes referimit udhëzimet e tij të mëparshme për Zyrën Administrative në lidhje me zbatimin e redaktimeve në materialin në audio dhe video të transkripteve të seancës gjyqësore përkatëse.<sup>7</sup>

## V. VENDIM

13. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **AUTORIZON** pjesërisht riklasifikimin si publik të pjesëve të transkripteve të Deklaratave Përmbyllëse dhe zbatimin më pas të redaktimeve në të, në pajtim me paragrafët 9-10 të këtij vendimi;
- b) **URDHËRON** Zyrën Administrative të riklasifikojë si publike pjesë të transkripteve të Deklaratave Përmbyllëse, në të gjitha gjuhët, me kusht që t'u bëhen redaktimet e autorizuara, sikundër përcaktohet në shtojcën e këtij vendimi;

---

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-04, F00579, Trupi Gjykses I, *Vendimi i Dytë mbi Heqjen e Redaktimeve apo Zbatimin e Redaktimeve të Reja në Transkriptet e Seancave Gjyqësore dhe Riklasifikimin e Tyre*, 11 korrik 2023, publik, para. 24-25, me Shtojcën 1, konfidenciale.

- c) **URDHËRON** Zyrën Administrative të zbatojë, sa të jetë teknikisht e mundur, redaktimet në materialin përkatës në audio dhe video të transkripteve përkatëse të Deklaratave Përmbyllëse në të gjitha gjuhët; dhe
- d) **URDHËRON** Njësinë e Administrimit të Gjykatës të Zyrës Administrative të lidhet me Trupin Gjykses nëse lind ndonjë problem lidhur me zbatimin e këtij vendimi.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatëse Mapi Feld-Folia,  
Kryegjykatëse**

/nënshkrimi/

---

**Gjykatës Zhilber Biti**

/nënshkrimi/

---

**Gjykatës Roland Dekers**

E enjte, 11 korrik 2024

Në Hagë, Holandë.